

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data 12/08/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Materiale për pajisjet e radiokomunikimit” për Policinë e Shtetit.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

Karikues 31158000-8

Bateri 31440000-2

Kufje 32342200-4

Antena 44212250-6

Vlera e fondit limit: 2,795,852.50 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit

tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 42 pika 3, neni 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të

mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh se vlera e fondit limit për të gjitha lotet është nën kufirin e ulët monetar dhe përcaktimeve të bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcakton se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë broshurë/skedë teknike/katalog nga prodhuesi për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohej, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si broshurë/katalogë/skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu broshura/katalogë/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

3.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesat 5 dhe 6 të mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”* Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".* Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, që furnizimi të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

4.Operatori ekonomik ofrues duhet të deklarojë se merr përsipër integrimin e aseteve në kapacitetet ekzistuese të pajisjeve të radiokomunikimit objekt prokurimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në*

lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Në këtë procedurë prokurimi do të realizohet blerja e materialeve për pajisje te radiokomunikimit, pjesë këmbimi të infrastrukturës ekzistuese të sistemit te radiokomunikimit të Policisë së Shtetit, të cilat do të integrohen në kapacitet ekzistuese. Nisur nga natyra e mallrave objekt prokurimi duke qene se keto pjesë do të instalohen në infrastrukturën ekzistuese është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të deklarojë se merr përsipër integrimin e asetëve në kapacitetet ekzistuese të pajisjeve të radiokomunikimit objekt prokurimi. Referuar si më lart, ky kriter është në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.
Skicimet, parametrat teknik etj

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike për blerjen e “Materiale për Paisjet e Radiokomunikimit” :

1. Ushqyes për radio baze/repertitor

- Tensioni në hyrje: 220-230 VAC
- Tensioni në dalje: 13,8 VDC
- Frekuenca në hyrje: 50Hz
- Rryma në dalje: 30A

2. Antenë UHF Omni direksionale

- Fibërglass
- Omni direksionale
- Brezi i frekuencës: 430-470 MHz
- Fuqia max: 70W
- Impedanca: 50Ω
- Gain: 5dBd-7dBi
- Konektor: N Female
- Temperaturë e punës: -35°C deri në 80°C

3. Antenë UHF Magnetike

- Magnetike e pershtatshme per automjete
- Brezi i Frekuences: 430-470 MHz
- Fuqia max: 35W
- Impedanca: 50Ω
- Gain: 3dBd
- Temperaturë e punës: -35°C deri ne 80°C
- Perfshire: Kabell RG-58 ne gjatesi 5m i lidhur ne bazamentin e antenes dhe ne krahun tjeter me konektor BNC.

4. Duplexer UHF me 6 kavitete

- Tx/Rx: 400-470 MHz
- Tx-Rx duplexim: 9-13MHz
- Fuqia max në hyrje: 50W
- Impedanca: 50 Ω
- SWR në cdo hyrje ≤ 1.5
- Stabilitet në frekuencë: 4,5ppm/°C
- Temperaturë e punës: -30°C deri ne 60°C
- Kavitete: 6
- Konektor: BNC female

5.Konektor për kabëll RG213U tip N-male

- Tip N male

- I përshtatshëm për kabëll RG-213U
- Montim me filetim

6. Konektor për kabëll RG213U tip N-female

- Tip N female
- I përshtatshëm për kabëll RG-213U
- Montim me filetim

7. Konektor për kabëll RG213U tip PL male

- Tip PL Male
- I përshtatshëm për kabëll RG-213U
- Montim me filetim

8. Konektor për kabëll RG213U tip PL female

- Tip PL Female
- I përshtatshëm për kabëll RG-213U
- Montim me filetim

9. Konektor për kabëll RG58 tip N-male

- Tip N Male
- I përshtatshëm për kabëll RG-58
- Montim me crimp

10. Konektor për kabëll RG58 tip N-female

- Tip N Female
- I përshtatshëm për kabëll RG-58
- Montim me crimp

11. Konektor për kabëll RG58 tip PL male

- Tip PL Male
- I përshtatshëm për kabëll RG-58
- Montim me crimp

12. Konektor për kabëll RG58 tip PL female

- Tip PL Female
- I përshtatshëm për kabëll RG-58
- Montim me crimp

13. Konektor për kabëll RG58 tip BNC

- Tip BNC
- I përshtatshëm për kabëll RG-58
- Montim me crimp

14. Garniturë radio stacionere Motorola DM-1400

- I përshtatshëm për radio stacionere Motorola DM-1400
- Funkcionaliteti që kryen: Transmetim/marrje audio të radios stacionere.
- Lidhja fizike me radio stacionere Motorola DM-1400

15. Garniturë radio stacionere Motorola DM-4601

- I përshtatshëm për radio stacionere Motorola DM-4601
- Funksionaliteti që kryen: Transmetim/marrje audio të radios stacionere.
- Lidhja fizike me radio stacionere Motorola DM-4601

16.Antenë radio dore Vertex EVX-531

- I përshtatshëm për radio dore Vertex EVX-531/534
- Konektor me filetim nga jashtë
- Gominë rrethore kundër lagështirës
- Frekuence e punës: 440-470MHz
- Etiketim i brezit të frekuencës ose model të antenës

17.Antenë radio dore Motorola EVX-261

- I përshtatshëm për radio dore Motorola EVX-261
- Konektor me filetim nga brenda
- Frekuencë e punës: 440-470MHz
 - Etiketim i brezit të frekuencës ose model të antenës

18.Bateri radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Vertex EVX-531/ Motorola EVX-261
- Performanca: FNB-V134LI
- Tensioni: 7.4V=
- Kapaciteti: 2300mAh
- Të shoqërohen me gjithë kapëse mbajtje baterie

19.Karikues bateri radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Vertex EVX-531/Motorola EVX-261
- Funksionaliteti që kryen: me dy pjesë përbërëse, adaptor tensioni dhe bazë karikimi i shpejtë.
- AC adapter PA-55C: tension në hyrje 220VAC±5%
- Tensioni në dalje: 16V=
- Kapaciteti: 1.0 A
- Desktop Charger: CD-58
- Llambë sinjalizimi për gjendjen e karikimit të baterisë

20.Garniture radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Vertex EVX-531/Motorola EVX-261
- Funksionaliteti që kryen: Transmetim/marrje audio të radios se dore.
- Lidhja fizike me radio dore Vertex EVX-531/Motorola EVX-261
- Standart IP54 dhe IP 57

Motorola DP-4800e

21.Bateri radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Motorola DP-4800e
- Performanca: Impres
- Tensioni: 7.4V=
- Kapaciteti: 2100mAh
- Të shoqërohen me gjithë kapëse mbajtje baterie

22.Karikues bateri radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Motorola DP-4800e
- Funksionaliteti që kryhen: me dy pjesë përbërëse, adaptor tensioni dhe bazë karikimi i shpejtë.
- AC adapter MH14: tension në hyrje 220VAC±5%
- Tensioni në dalje: 14V=
- Kapaciteti: 1.0 A
- Desktop Charger: Impres adaptive charger
- Llambë sinjalizimi për gjendjen e karikimit të baterise

23.Kufje/PTT e jashtme

- | | |
|--|----------|
| • I përshtatshëm për radio dore Motorola DP-4800e | |
| • Konektor Multi Pin | Po |
| • Teknologjia e lidhjes me radion | Kabell |
| • Kompaktibel per model Motorola DP4800 | Po |
| • Pulsante PTT per aktivizm mikrofoni | Po |
| • Mbajtese e kufjes ne forme G te regullueshme
(te marre forme e vendosjes ne vesh) | Po |
| • Pesha | ≤70 gram |
| • Azhornim software | Jo |
| • Funksionalitet me regjim bateri | Jo |

Belfone BF-TD930

24.Antenë radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Belfone BF-TD930
- Konektor me filetim nga jashtë
- Frekuence e punës: 440-470MHz
- Etiketim i brezit të frekuencës ose model të antenës

25.Bateri radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Belfone BF-TD930
- Perberja bateri pack BF-A50
- Tensioni: 7.4V=
- Kapaciteti: 2300mAh

26.Karikues bateri radio dore

- I përshtatshëm për radio dore Belfone BF-TD930
- Funksionaliteti që kryhen: me dy pjesë përbërëse, adaptor tensioni dhe bazë karikimi i shpejtë.
- AC adapter: tension në hyrje 220VAC±5%
- Tensioni në dalje: 9.2V=
- Kapaciteti: 800 mA
- Desktop Charger: BF-B42
- Llambë sinjalizimi për gjendjen e karikimit të baterise

27.Kufje/PTT e jashtme

- | | |
|--|----|
| • I përshtatshëm për radio dore Belfone BF-TD930 | |
| • Konektor Multi Pin | Po |

• Teknologjia e lidhjes me radion	Kabell
• Kompaktibel per model Belfone TD930	Po
• Pulsante PTT per aktivizim mikrofoni	Po
• Mbajtese e kufjes ne forme G te regullueshme (te marre forme e vendosjes ne vesh)	Po
• Pesha	≤70 gram
• Azhornim software	Jo
• Funksionalitet me regjim bateri	Jo

28.Aparat mates parametra Rx/Tx repertitor

- Diapazoni i frekuences 100kHz...3GHz
- I përshtatshëm për matje fuqie HF,VHF,UHF
- I pershtatshem per matje ndjeshmeri Rx
- I pershtatshem per matje modulim
- Tracking generator -20...0dBm
- Temperatura e stabilitetit ±2ppm (0..30°C)
- Display : 16.5cm TFT color
- Tension ne hyrje 220VAC±5%
- Pesha 3,6 Kg
- Te shoqerohet me aksesorte perkatese, si dhe manual perdorimi

29.Cantë me konektor adaptore

- Adaptore të jenë të modeleve të ndryshme
- Të përshtatshëm me konektorët e aparateve matëse.
- Kit konektor RF
- Kalimi i konektoreve BNC-PL male, BNC-EN male, PL male-EN male, PL female-EN female, PL female-EN male, PL male-EN female ne UHF adapter

30.Fasheta plastike te medha

31.Nastro elektrike

32.Nastro izoluese zifti

Argumentimi i specifikimeve teknike nga ana e Autoritetit Kontraktor Përfitues:

Përdorimi i parametrave të fiksuar për këto pjesë është i domosdoshëm për arsyet vijuese:

- **Kompaktibiliteti me pajisjet ekzistuese:** Pjesët e reja duhet të jenë të përshtatshme në mënyrë të plotë me pajisjet ekzistuese. Parametrat teknikë, sigurojnë që pjesët e reja te kembimit integrohen përputhshmërisht pa ndërprerje dhe pa nevojën për ndryshime të mëtejshme në infrastrukturën ekzistuese.
- **Siguria dhe performanca e sistemit:** Parametrat e saktë garantojnë funksionimin e sigurt dhe performancën optimale të sistemit te radiokomunikimit, duke shmangur difektet, ndërprerjetë transmetimit ose dëmtime të pajisjeve ekzistuese.
- **Standardet dhe përputhshmëria:** Pjesët jo-kompaktibile mund të shkaktojnë difekte në sistemin e radiokomunikimit, deri në shkaterim të vete pajisjes, ndërprerje të komunikimitradio. Parametrat fikse garantojnë që pjesët e reja plotësojnë të njëjtat standarde dhe karakteristika si ato origjinale,

Këto specifikime nuk synojnë të kufizojnë konkurrencën, por janë të domosdoshme për sigurinë, funksionimin optimal dhe **përputhshmërinë e sistemit ekzistues të radiokomunikimit në Policinë e Shtetit.**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupet e punës të ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Policia e Shtetit, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT